




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12 par. 12.1, dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 të Ligjit për financimin e Programeve të veçanta të banimit Nr.03/L-164 si dhe neneve 9 dhe 20 par 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 20. 12.2019, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM
PËR HARTIMIN E PROJEKTIT TË PROGRAMIT KOMUNAL TRE VJEQAR PËR
BANIM 2020-2023

Neni 1

TË HARTOHET, Programi Komunal tre-vjeqar për banim 2020-2023.

Neni 2

1.Qëllimi i hartimit të Programit për banim në Komunën e Lipjanit rezulton në:

- Krijimin e kushteve për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me standardet dhe normat evropiane të banimit,
- Zhvillimin e politikave adekuate dhe zbatimin e tyre me qëllim që të mundësohet zgjidhja e nevojave për banim për grupe të caktuara të cilat nuk kanë forcë ekonomike që këtë problem ta zgjidhin sipas parimeve të tregut.

Neni 3

Programi Komunal i banimit do të hartohet për periodë tre vjeqare 2020-2023, duke u mbështetur në analizën e nevojave për banim, konform dispozitave të Ligjit për financimin e Programeve të veçanta të banimit Nr.03/L-164 dhe akteve nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

Neni 4

1.Bartës i procesit të hartimit të dokumentit të Programit Komunal tre-vjeqar për banim deri në finalizim do të jetë Komisioni Komunal i cili do të formohet me Vendim të Kryetarit të Komunës menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi. Në përbërje të Komisionit kryesisht duhet të përfshihen zyrtarë nga Drejtorati për

Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale si dhe zyrtarë tjerë nga administrata komunale.

2. Punët administrative teknike për punën e Komisionit do t'i kryej Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.


Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës

Nr.15- 360-79229

Lipjan, më 20. 12. 2019

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi